



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2019:118394

Datë: 22.07.2021

Numri i dokumentit: 02019023

C.nr.02/18

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ- Dega në Kaçanik, si gjykatë civile e shkallës së parë, gjyqtari Riza Livoreka, si gjyqtar individual, me sekretaren juridike Azemine Berisha, duke vendosur në çështjen kontestimore juridiko-civile të paditësit N.G nga fshati ..., Komuna Kaçanik, të cilët me autorizim i përfaqëson D. R., avokate nga Kaçaniku, kundër të paditurës Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut – ... Sh.a me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson N. J. për çështjen kontestuese kompenzimi i dëmit material, në seancën kryesore të mbajtur më datën 22.06.2021 në praninë e të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, ndërsa me datën 22.07.2021, bëri përpilimin me shkrim të këtij:

A K T G J Y K I M

I.MIRATOHET, pjesërisht si e bazuar kërkespacia e paditësit N.G nga fshati, Komuna Kaçanik dhe **DETYROHET** e paditura Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut– ... Sh.a, me seli në Prishtinë, që paditësit të i'a paguaj shumën prej 10.897.00€ në emër të dëmit të shkaktuar edhe ate:

- Për prerjen e pyllit në ngastrën kadastrale 2504-0, në vendin e quajtur „...“ me kulturë mal i klasës së parë, në sipërfaqen prej 1709 m², për sasinë drunore prejë 68.34 m³ X 50 €/m³=3417 €.

- Në emër të vlerës së humbur për rritjen e masës drunore të pyllit të dëmtuar në ngastrën kadastrale 2504-0, në vendin e quajtur „...“ me kulturë mal i klasës së parë, për

sipërfaqen prej 1709 m² , për periudhën kohore prej 68 viteve sasinë prej 149.6 m³ X 50 €/m³=7.480 €, e gjithësejt për pagesë shumën prej 10.897.00 €

Këtë shumë me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga data 05.01.2018(data e paraqitjes së padisë) e deri në pagesën definitive.

II.Refuzohet si e pa bazuar pjesa tjetër e kërkesë padisë mbi shumën e gjykuar edhe ate për shumën prej 246.01 €, për dëmtimin e pyllit dhe në emër të fitimit të humbur.

III.DETYROHET e paditura që paditësit të i'a paguaj shumën nga pika I e këtij aktgjykimi si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 1.633.20€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditësit përmes të autorizuarit, si në padi ashtu edhe në seancat e mbajtura gjyqësore i kanë propozuar gjykatës që padinë e paditësit ta miratoj në tërësi si të bazuar, dhe ka kërkuar që të obligohet e paditura që paditësit të i'a kompenzoj dëmin dhe fitimin e humbur në shumë prej 11.143.01€ edhe ate në emër të drunjëve të prerë në ngastrën 02504-0 në vendin e quajtur „...“ mal Ferina, me kulturë mal i kalsës së parë shumën prej 3.623,01 € dhe në emër të fitimit të humbur shumën prej 7520 €.

I autorizuari ka theksuar se nga ekspertiza e ekspertit të gjeoezisë është konstatuar se nga e paditura është bërë prerja e masës drusore në Pk.nr. 2504-0 në sipërfaqe prej 1709 m² ec ila ngastër gjindet në Zonën Kadastrale ... me numër 941-0000-166/2018 e evidentuar në emër të paditësit.

I autorizuari ka theksuar se ekspertizat e bëra është konstatuar prerja e masës drunore siq është përshkruar në ekspertizë e që konsiderohet dëmi real. Duke marrë parasysh vegjitacioni-drunjët sipas ekspersit për të arritur madhësinë për shfrytëzim nevojitet periudha prej 25 deri 31 vjet, kështu që në rastin konkret përveq dëmit real është shkaktuar edhe fitim i

humbur nga se paditësi për një kohë të gjatë nuk mund ta shfrytëzoj masën drusore në paluajtëshmërin e tijë.

Nga ekspertiza e gjoedezisë është vërtetuar se kjo paluajtëshmëri nuk ka asnjë barrë dhe nuk egziston asnjë vendim i organit kompetent apo marrëveshje për caktimin e të drejtës së servitutit, çka na rezulton se e paditura pa lejen dhe pa pëlqimin e paditësit e ka bërë prerjen e drunjëve në pasurinë private duke i shkaktuar dëm paditësit.

E paditura duhet të ja kompenzoj dëmin paditësit edhe atë konform nenit 5 pika 32 e UA të MZHE nr.03/2018 mbi rregullat për zonta të sigurisë. Kjo dispozitë përcakton se gjdo ndërmarrje e energjisë që largon vegjetacionin, apo drunjët nga zona e sigurisë, duhet të (pika 3.2) të mbuloj të gjitha shpenzimet, ndërsa pika 4 e po të njejtit nen e përcakton decitivisht se „Ndrëmarrja e Energjisë janë përgjegjëse për çfardo dëmi të shkaktuar në pronë, sipas kushteve të parapara me legjislacionin në fuqi“.

Po ashtu ka theksuar se me Ligjin për Energjinë edhe atë neni 26 është e përcaktuar se „vetëm nëse ndërmarrja përkatëse ka një servitut ose të drejtë shfrytëzimi të pronës përkatëse.

E autorizuar e paditësve ka deklaruar se baza e kërkesëpadisë së paditësve është e mbështetur në dispozitën materiale të nenit 30 par1 të Ligjit me nr. 05/L-081 për energjinë si dhe nenit 136 të LMD-së. Me këtë dispozitë është përcaktuar se kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompenzoj përveq nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tijë. Me nenin 173 par.1 të LMD-së, është përcaktuar se i dëmtuar ka të drejtë për shpërblim të dëmit të rëndomt ashtu edhe për shpërblim të fitimit të humbur, ndërsa me paragrafin 3 të po këtijë nenit është përcaktuar se gjatë vlersimit të lartësis së fitimit të humbur merret në konsiderim fitimi që ka mundur të pritej sipas rrjedhjes së rregullt të gjërave . Nga këto baza ka kërkuar nga Gjykata që kërkesëpadinë e paditësit ta miratojë në tërsi si të bazuar.

Shpenzimet i ka kërkuar.

E paditura si në përgjigje në padi ashtu edhe gjatë seancave të mbajtura gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare me shkrim i ka propozuar gjykatës që kërkesë padinë e paditësit ta refuzoj në tërësi si të pa bazuar.

Nga administrimi i propave është konstatuar se padia e paditësit është tërësisht e gabuar sa i përket bazës së kërkesë padisë, nga se dëmet e shkaktuara në pronën e paditësit në masën drusore nga anan e kostit është bërë për arsye të evitimit të pengesave me qëllim të mirmbqajtjes dhe mbrojtjes së zonës së sigurisë, bazuar në Ligjin numër 05/:L81 Ligji për Energjinë dhe UA nr.03/2017 mbi rregullat për zonat e sigurisë .

Po ashtu e ka kontestuar edhe ekspertizën e ekseptit të pylltarisë Q. K. duke theksuar se me rastin e dhënjes së mendimit dhe konstatimit nuk rezulton se dëmi i shkaktuar është llogaritur sipas vlerës së tregut në kohën kur është shkaktuar dëmi siq është konstatuar në ekspertizë.

Po ashtu edhe pas nxjerrjes së ekspertizës së re nga ana e ekspertit nuk është bërë analizë e mirëfillt për të dhënë një mendim dhe konstatim real të vlerës së tregut për pronën lëndore. Nga këto prova na rezulton se pala e paditur nuk duhet të kompenzoj për prerjen e masës drunore spese kjo masë drunore është prerë në zonën e sigurisë të trasës së lartë përquesit nr.240/1 NS-Ferizaj 2-NS Shkupi 5, prandaj duke i pasur për bazë këto fakte i ka propozuar gjykatës që kërkesë padinë e paditësit ta refuzoj në tërësi si të pa bazuar.

Shpenzimet nuk i ka kërkuar.

Për ta vërtetuar gjendjen e plotë faktike dhe gjykuar drejtë këtë çështje kontestimore juridiko-civile gjykata me propozimin e paditësit dhe të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse në procedurën e provave bëri administrimin e këtyre provave të shkruara: u lexuan certifikata e pronës, përgjegja në padi, Ekspertiza e ekspertit të gjeodezisë, me pjesë grafike, raportet e vlerësimit të ekspertëve Q. K. dhe A. S., pa pyetje dhe pa verejtje.

Pas vlerësimit me kujdesë dhe me ndërgjegjje të provave në tërësi dhe të secilës veq e veq e në pajtim me dispozitat e nenit 7 dhe 8 të LPK-së dhe bindjes së lire të gjykatës, gjykata lidhur me këtë çështje kontestimore juridiko-civile vërtetoi këtë gjendje faktike:

Ngastra kadastrale ku është shkaktuar dëmi është pronë e paditësit dhe me culture mal. Ky mal është prerë nga e paditura pa lejen e paditësit, është prerë për mirëmbajtjen e rrjetit

transmetues të energjisë elektrike. Nga kjo prerje paditësit kanë pësuar dëm dhe fitim të humbur në shumë prej 10.897.00€ .

a) Se ngastra kadastrale është e paditësit këtë fakt gjykata e ka vërtetuar nga ekspertiza e ekspertit të gjeodezisë, i cili ka konstatuar se në ngstën kadastrale 2504-0 është bërë prerja e pyllit (drunjëve) evidentohet në emër të N. B. G. nga fshati Poashtu ky fakt është vërtetuar edhe nga certifikata e pronëse e cila gjindet në shkresat e lëndës, ky fakt nuk ishte kontestues në mes të palëve.

b) Se ngastra ku është shkaktuar dëmi është me kulturë mal, këtë fakt Gjykata e ka vërtetuar nga certifikata e pronës, ekspertiza e ekspertit të gjeodezisë si dhe ekspertiza e ekspertit të pylltarisë. Të cilët kanë konstatuar se kjo ngastë është me culture male e klasës së parë, ky fakt nuk ishte kontestues mes palëve ndërgjyqëse.

c) Se drunjët në ngastrën e paditësit janë prerë nga e paditura këtë fakt Gjykata e ka vërtetuar nga thënjet në padi, theksimeve të bëra gjatë këtij procesi gjyqësorë si dhe nga përgjegjja në padi, ku e paditura ka theksuar se prerja e masës drusore mbi të cilën është shkaktuar dëmi është bërë në trasenë e lartë përquesit nr. 240/1 NS – Ferizaj 2 – NS - Shkupi 5, edhe fakt nuk ishte kontestues në mes palëve.

d) Se nga kjo prerje paditësi ka pësuar dëm dhe fitim të humbur që arrinë vlerën prej 10.897.00 €, këtë fakt Gjykata e ka vërtetuar nga raporti i vlerësimit të ekspertit vlerësues A. S., i cili ka konstatuar se paditësi ka pësuar dëme në shumë prej 10.897.00 € edhe ate : Për prerjen e pyllit në ngastrën kadastrale 2504-0, në vendin e quajtur „Kuqishtë “ me kulturë mal i klasës së parë , në sipërfaqen prej 1709 m² , për sasinë prej 68.34 m³ X 50 €/m³=3417 €. Ndërsa në emër të vlerës së humbur për rritjen e masës drunore të pyllit të dëmtuar në sipërfaqen prej 1709 m² , për periudhën kohore prej 68 viteve sasinë prej 149.6 m³ X 50 €/m³=7.480 €, e gjithësejt për pagesë shumë prej 10.897.00 €.

Gjykata pas analizimit të theksimeve të pales paditëse si dhe provave të cilat gjindnen në shkresat e lëndës kërkesëpadinë e paditësit e miratoi pjesërisht si të bazuar dhe e detyroi të paditurën që paditësit të i'a paguaj shumën prej 10.897.00 € në emër të dëmit dhe fitimit të humbur.

Në emër të dëmit e ka detyruar të paditurën ta paguaj shumën prej 3.417 €, këtë shumë e ka caktuar duke u bazuar në ekspertizën e ekspertit vlerësues. Eksperti vlerësues në ekspertizën e tijë ka konstatuar se një pjesë e ngastrës së pyllit të prerë ka qenë pyll cilësorë i dendur me numër të madh të drunjëve të llojeve drurore të dushqeve (bung), qarri dhe shpardhi. Llogaritja e dëmit të shkaktuar është bërë sipas kritereve që dalin nga Ligji për Pyjet e Kosovës numër 2003/03, konfrom neneve 20,21 dhe 32. Po ashtu llogaritja është bërë sipas Udhëzimit Administrativ MA-nr.12/15 të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. E kjo është e laboruar në faqen 4 dhe 5 të raportit të vlerësimit.

Gjykata e ka detyruar të paditurën që paditësit të i'a paguaj edhe fitimin e humbur në shumë prej 7.480,00 € sepse këtë dëm e ka pësuar me fajin e të paditurës, fakte këto të konstatuara nga mendimi i ekspertit të pylltarisë dhe vlerësues. Me nenin 173 par. 1 të LMD-së është e paraparë se i dëmtuari ka të drejtë si me shpërblimin e dëmit të rëndomtë ashtu edhe për shpërblimin e fitimit të humbur. Ndërsa me po të njejtin nen në par.3 është e paraparë se gjatë vlersimit të lartësisë së fitimit të humbur merret në konsiderim fitimi që ka mundur të pritej në mënyrë të bazuar sipas rrejdhes së rregullt të gjërave ose sipas rrethanave të veçanta e realizimi i të cilit është penguar nga veprimi i dëmtuesit ose nga lëshimi që të ndërmer veprim

Gjykata e ka detyruar të paditurën që paditësit të i'a paguaj këtë dam sepse e paditura pos që e ka dëmtuar paditësin edhe e ka kufizuar në shfrytëzimin e kësaj prone, këtë fakt gjykata e ka vërtetuar nga provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës.

Po ashtu me rastin e mirtimit të pjesërishtëm të kërkesë padiës gjykata e ka pasur parasyshë faktin se e paditura e ka dëmtuar pronën e paditësit pa zhvilluar kurrfar procedure të paraparë me Ligj. Gjykata këtë fakt e ka vërtetuar nga ekspertizat e ekspertëve të ciltë kanë konstatuar se prerja e pyllit është bërë në kundërshtim me dispozitat ligjore sepse nuk është krijuar servitut nga e paditura, nuk është bërë shpronësimi i pronës apo edhe ndonjë form tjetër e paraparë me Ligj.

Kësaj ekspertize gjykata ja fali besimin sepse ekspertët e kanë hartuar konform dispozitave ligjore, prandaj gjykata duke u bazuar në nenin 30 të ligjit nr. 05/L-081 për Energjinë Elektrike si dhe duke u bazuar në nenin 136 të LMD-së sepse me këtë dispozitë është paraparë se kush i shkakton dëm tjetrit ka për detyrë ta kompenzojë. Poashtu e ka aplikuar edhe dispozitën e nenit 169 par.3 të LMD-së.

Gjykata një pjesë të kërkesë padisë së paditësit e refuzoi si të pa bazuar për shumën prej 246.01 €, për dëmtimin e pyllit dhe në emër të fitimit të humbur, spese nga ekspertiza e ekspertit vlerësues A. S. e të cilën pala paditëse nuk e ka kontestuar na ka rezultuar se dëmi i pësuar dhe fitimi i humbur janë më të ulët se dëmi dhe fitimi i humbur të konstatuara me ekspertizën e ekspertit të pylltarisë.

Meqenëse e paditura ka rënë në vonesë me kompensimin e dëmit Gjykata me kërkesën e paditësit dhe në bazë të nen.382 të LMD-së, e detyroi të paditurën që paditësit në shumat e gjykuara t'ia paguaj edhe kamatën vjetore prej 8% edhe ate duke fillua nga data 05.01.2018,(data e paraqitjes së padisë), e deri në pagesën definitive. Gjykata e detyroj të paditurën që ta paguaj këtë shumë sepse kemi të bëjm me dëm material dhe me rastin e caktimit të fillimit të llogaritjes së kamatës ka vepruar komform Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës Nr.265/20 i datës 02.12.2020 pika XVII e dispozitivit të këtij Mendimi si dhe konform nenit 2.1 të LPK-së.

Gjykata i analizoi theksimet e pales paditëse e cila i propozoi gjykatës që kërkesëpadinë e paditësve ta miratojë në tërsi si të bazuar dhe ta detyrojë të paditurën që paditësve të i'a paguaj shumën prej 11.143.01€ në emër të dëmit dhe fitimit të humbur. Këtyre theksimeve Gjykata u'a dha besimin pjesrishtë dhe e detyroi të paditurën që paditësit të i'a paguaj dëmin dhe fitimin e humbur sepse këtë dëm dhe fitim të humbur paditësit e kanë pësuar me fajin e të paditurës e këtë fakt Gjykata e ka vërtetuar nga provat të cilat gjindne në shkresat e lëndës.

Se ky dëm është shkaktuar nga e paditura këtë fakt Gjykata e ka konstatuar nga përgjegjja në padi e të paditurës ku është shënuar se prerja e masës drusore është bërë për shkak të pastrimit të trasës së lartëpërquesit nr.240/1 NS Ferizaj 2 NS – Shkupi 5 dhe kjo prerje është bërë me qëllim të mbrojtjes së zonës së sigurisë duke u bazuar në ligjin nr. 05/L-081 Ligjit për Energjinë dhe UA nr. 2005/7 mbi Zonat e mbrojtura.

Gjykata i analizoi pretendimet e palës së paditur e cila i propozoj gjykatës që kërkesë padin e paditësit ta refuzoj si të pa bazua, për arsye se e paditura këtë mal e ka prerë për evitimin e pengesave me qëllim të mirëmbajtjes dhe mbrojtjes së zonës së sigurisë .

Gjykata këto nuk i mori për bazë me rastin e vendosjes spese e paditura është përgjegjëse për dëmin e shkaktuar, e paditura nuk e ka shpronësuar, nuk ka krijuar servitut , nuk ka marrë leje nga tani paditësi për pastrimi ne kësaj zone prandaj duke i marrë për bazë të gjitha këto fakte vendosi si më lartë.

Gjykata e obligoi të paditurën që paditësit të i'a kompenzoj shpenzimet e procedures kontestimore në shumë prej 1.633.20€, edhe ate shumën prej 208€ për përpilimin e padisë, shumën prej 194 €, në emër të ekspertizës së gjeodezisë, shumën prej 320 për pagesën e ekspertizës nga lëmia e pylltarisë, shumën prej 811.20 € për 3 seanca të mbajtura gjyqësore dhe shumën prej 100 € në emër të taksës për padi. të parapara me Udhëzimin Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore 01/2017 dhe konform nenit 452.1 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-
DEGA NË KAÇANIK
C.nr.02/18 e datës 22.06.2021

GJYQTARI
Riza Livoreka

UDHËZIM JURIDIK:

Kundër këtijë aktgjykimi pala e paknaqur
Ka të drejt ankes në afat prej 15 ditësh nga
dita e pranimit të aktgjykimit, ankesa i paraqitet
Gjykatës së Apelit në Prishtinë
përmes kësaj gjykate.

Ekspeduar me datën 22.07.2021

Paditësit 1x1

Të padiurës 1x1